

V E N D I M
Nr.43, datë 4.6.1999

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga :

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““

Me sekretare Drita Filto, më datë 08.04.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.39 Akti që i përket :

K E R K U E S: RUSHIT DEMO, i biri i Dervishit dhe i Zabikos, i dtl.1963, lindur në Tepelenë e Banues në Tiranë, i përfaqësuar nga avokati Sadedin Xhafo.

SUBJEKT I INTERESUAR: KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, në mungesë.

O B J E K T I :

Shfuqizimi si antikushtetues i Vendimit nr.1462, datë 03.11.1998 të Kolegjeve të Bashkuara të ish-Gjykatës së Kasacionit.

BAZA LIGJORE:Nenet 34/dh, 35, 43, 44, etj., të Ligjit nr.8373, datë 15.07.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të Vendimit:

Si Këshilli i Lartë i Drejtësisë ashtu edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit, masën e largimit tim nga detyra e gjyqtarit e kanë marrë në kundërshtim me ligjin, pa e bazuar atë në prova dhe duke e gjykuar çështjen në mënyrë krejt të njëanshme. Konkretisht, Këshilli i Lartë i Drejtësisë më ka mohuar të drejtën kushtetuese për t’u dëgjuar përpara se të vendoste për këtë masë.

Një mënyrë e tillë gjykimi vjen në kundërshtim me nenin 38 të Ligjit për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, me nenin 42/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe me Rezolutat nr.40/32, datë 29.11.1985 e nr.40/146, datë 13.12.1985 të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Shkelje të kësaj natyre kanë lejuar edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit në shqyrtimin e ankimit tim kundër Vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilin ata e lanë në fuqi.

Në këtë gjykim kanë marrë pjesë si gjyqtarë, dy anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që kanë votuar edhe këtu për largimin tim nga detyra. Për më tepër, duke qenë relatore e çështjes Natasha Sheshi, si anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, unë dyshoj se ajo ka ndikuar në mënyrë të ndjeshme në disfavorin tim, duke orientuar gabimet Kolegjet;

Vendimi i kolegjeve edhe nga pikëpamja formale nuk është i rregullt, sepse në pjesën hyrëse të tij nuk pasqyron pjesëmarrjen në këtë proces të prokurorit dhe përfaqësuesit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë si edhe mendimet që këta kanë shfaqur për çështjen.

GJYKATA KUSHTETUESE, Pasi dëgjoi shpjegimet e kërkuesit dhe të përfaqësuesit të tij, dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr.4, datë 10.11.1997 ka vendosur shkarkimin e kërkuesit Rushit Demo nga detyra e gjyqtarit, me motivacionin se: “pa shkaqe të arsyeshme nuk është paraqitur në punë për një kohë të gjatë”.

Mbi ankimin e tij çështja është shqyrtuar në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit dhe këta, me vendimin e tyre nr.1462, datë 3.11.1998 kanë vendosur lënien në fuqi të vendimit të sipërm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Duke e kundërshtuar këtë vendim të Kolegjeve të Bashkuara, përpara kësaj Gjykate, kërkuesi

përsëri ka pretenduar se nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nuk është dëgjuar aty paraprakisht, për të realizuar të drejtën e mbrojtjes.

Nga shpjegimet e tij dhe materialet e tjera të dosjes gjyqësore del se nuk ka asnjë lloj prove shkresore, që të vërtetojë thirrjen e tij për t'u paraqitur përpara Këshillit të Lartë të Drejtësisë ose të paktën të tregojë se ai është vënë në dijeni më përpara mbi shkaqet për të cilat Ministri i Drejtësisë ka propozuar masën e shkarkimit të tij nga detyra.

Këto pretendime në adresë të këtyre organeve, kërkuesi i ka ngritur edhe në Kolegjet e Bashkuara, por prapësimet e tij rreth themelit të çështjes, nuk janë pranuar me arsyetimin se janë të pabazuara.

Megjithatë, Gjykata konstaton se Kolegjet e Bashkuara në vendimin e tyre nuk kanë analizuar fare shkeljet e lartpërmendura të lejuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Është e vërtetë se gjatë gjykimit të çështjes ata e kanë dëgjuar kërkuesin, i kanë krijuar atij mundësinë të mbrohet me avokat, të ngrejë aty një varg pretendimesh dhe të paraqesë edhe prova për vërtetimin e tyre, por të gjitha këto janë të pamjaftueshme, për ta konsideruar këtë një proces të rregullt ligjor. Kjo për arsye se kur shqyrtohet ligjshmëria dhe bazueshmëria e vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kolegjet duhet të ushtrojnë kontroll të plotë dhe të mbajnë qëndrim ndaj çdo shkelje të vërtetuar në veprimtarinë e tij.

Rëndësi të veçantë merr trajtimi i atyre shkeljeve që çenojnë të drejta themelore siç është e drejta e mbrojtjes ose vlera të tjera kushtetuese që kanë të bëjnë me pavarësinë e gjyqtarit. Këto shkelje në asnjë rast nuk duhet të anashkalohen. Duhet të vlerësohet drejt shkalla e ndikimit të tyre në zgjidhjen e çështjes ose kur ekziston mundësia e korrigjimit të tyre, Kolegjet e Bashkuara, të paktën duhet t'ia venë ato në dukje Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim që ky, të mos i përsërisë në të ardhmen.

Kërkesa për respektimin e së drejtës së gjyqtarit për t'u dëgjuar paraprakisht, është e detyrueshme jo vetëm për gjykatën që shqyrton ankimin, por edhe për organin që është i autorizuar me ligj për të vendosur për masën e shkarkimit të tij nga detyra.

Një kërkesë e tillë parashikohet nga normat kushtetuese dhe në mënyrë më të detajuar në "Parimet themelore në lidhje me pavarësinë e drejtësisë" të formuluar këto nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në rezolutat e saj nr.40/32 e 40/146 të miratuara respektivisht në nëntor e dhjetor të vitit 1985.

Veç sa sipër, Gjykata çmon se procesi gjyqësor i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit, është shoqëruar edhe me mangësi të tjera më të rënda që çenojnë seriozisht parimin e paanësisë së Gjykatës në zgjidhjen e çështjeve.

Në këtë këndvështrim është për t'u përmendur fakti, se në përbërjen e trupit gjykues që ka shqyrtuar ankimin e kërkuesit, janë përfshirë edhe dy anëtarë të Gjykatës së Kasacionit, të cilët efektivisht janë edhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Për më tepër nga aktet del se të dy këta gjyqtarë kanë marrë pjesë dhe kanë vendosur për çështjen konkrete dhe në kohën kur kjo është shqyrtuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Pavarësisht nga votat që kanë dhënë këtu, në favor apo në disfavor të kërkuesit, pjesëmarrja e tyre edhe në Kolegjet e Bashkuara ka vënë objektivisht në dyshim paanësinë e Gjykatës në gjykimin e çështjes. Madje, përfaqësuesi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kërkuar që në fillim që ata të përjashtohen nga gjykimi dhe këtë kërkesë të tij e përkrahu si të drejtë edhe kërkuesi në shpjegimet e tij përpara Gjykatës Kushtetuese.

Në këto rrethana, kjo Gjykatë çmon se pjesëmarrja ose lejimi i tyre për të gjykuar përsëri mbi këtë çështje në Kolegjet e Bashkuara, ka qenë një shkelje flagrante e nenit 11 të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Në këtë dispozitë parashikohej në mënyrë të shprehur se: "Gjyqtarët janë të detyruar të mos marrin pjesë në zgjidhjen e çështjeve, kur ka shkaqe ligjore që kompromentojnë paanësinë e tyre si dhe të mënjanojnë çdo sjellje, që ve në dyshim real drejtësinë ose ul dinjitetin e saj".

E njëjta gjë iu imponohet atyre edhe nga neni 72 pika 5 e Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështje konkrete, midis të tjerash edhe kur ai ka një detyrë tjetër në institucion që ka interesa për çështjen në gjykim.

Pra, mosrespektimi i këtyre kërkesave me karakter kushtetues dhe ligjor, si nga këta anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që nuk janë tërhequr vetë nga ky gjykim, ashtu edhe nga anëtarët e tjerë

të Gjykatës së Kasacionit, që nuk kanë vendosur për përjashtimin e tyre nga trupi gjykues, sjell në mënyrë të pashmangëshme shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të sipërpërmendur të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit, pasi një vendim i tillë cënon të drejtat themelore që kanë të bëjnë me një proces të rregullt ligjor dhe një gjykim të drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme.

PER KETO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 132 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 41 të Ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.1462, datë 3.11.1998 të Kolegjeve të Bashkuara të ish-Gjykatës së Kasacionit, me qëllim që çështja të shqyrtohet përsëri prej tyre si organ tashmë i Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 4.6.1999

Nr. 39 i regjistrimit themeltar.

Nr. 43 i vendimit.